REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/909
Nr. i faq. 13
Data 05/02/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/04
Datë:02.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut, neni 31 i rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqsitë natyrore dhe fatkeqsitë tjera, Kuvendi i Komunës më 02.02.2026 nxjerrë:

V E N D I M

Për miratimin e raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e të reshurave të shiut dhe vërshimeve në Komunën e Junikut

I. Miratohet Raporti i vlerësimeve të dëmeve të shkaktuara nga të reshurat e shiut dhe vërshimet në Komunën e Junikut, të datës 05-06-07/01/2026.

II. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Vlerësimeve të dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe vershimet në Komunën e Junikut, të datës 09.01.2026, i hartuar nga Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut dhe vershimet.

III. Ky vendim hyn ne fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- Ministria e Pushtetit Lokal,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Lolluni

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/777
Nje. Org. 2
Nr. i faq. 1
Data 02/02/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

DATË:	02.02.2026
PËR/ZA/TO:	**z. Leonard Llolluni** - Kryesues i Kuvendit
CC:	**z. Ruzhdi Shehu** – Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	//
NGA/OD/FROM:	**z. Shkelzen Shehu – Kryesues i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat e shiut dhe vërshimet**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), të Statutit të Komunës së Junikut (Nr. 001/3127, datë 29.09.2010), si dhe Rregulloren për Punën e Kuvendit të Komunës së Junikut, ju paraqesim këtë:

K Ë R K E S Ë

Që në rendin e ditës së mbledhjes së radhës të Kuvendit Komunal të përfshihet miratimi i Raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat dhe vërshimet.

Të bashkëngjitur gjeni Raportin e lartëcekur.

Me respekt,

1-130/778
11
02/02/2026

RAPORT

DËMET E SHKAKTUARA NGA TË RESHURAT E SHIUT DHE VËRSHIMET

Paporti i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga të reshurat e shiut dhe vërshimet

1. HYRJE

Si pasojë e reshjeve të dendura dhe të vazhdueshme të shiut që kanë përfshirë territorin e Komunës së Junikut, janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore dhe ujore. Reshjet intensive kanë ndikuar drejtpërdrejt në destabilizimin e terrenit, rritjen e prurjeve ujore, rrëshqitjen e dheut dhe erozionin e shtratit të lumenjve.



Me qëllim të evidentimit dhe dokumentimit të gjendjes reale në terren, është formuar Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve, i cili ka realizuar vizita në zonat e prekura dhe ka evidentuar dëmet e shkaktuara.

2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës, z. Ruzhdi Shehu, nr. 01/11 të datës: 09.01.2026, është formuar komisioni për vlerësim të dëmëve të shkaktuara në infrastrukturën rrugore, ujore si dhe në pronat private dhe bizneset nga reshjet e rrembyeshme te shiut me 05, 06 dhe 07 janar, si dhe reshjeve të vazhdueshme të ditëve në vijim pas këtyre datave.

Për vlerësim sa më real të dëmeve të shkaktuara, komisioni ka dalë në teren dhe ka vizituar të gjitha zonat e prekura nga reshjet e shiut dhe vërshimet, duke mbledhur informacione dhe mbajtur shënime se në cilat zona ka pasur dëme nga shirat e rrëmbyeshëm

Komisioni ka kryer:

- Vizita direkte në terren në lokacionet e prekura,
- Inspektim vizual të infrastrukturës rrugore dhe ujore,
- Dokumentim fotografik të dëmeve,
- Evidentim dhe përshkrim të gjendjes faktike në terren.

Të dhënat e këtij raporti bazohen në konstatimet e drejtpërdrejta të anëtarëve të komisionit gjatë inspektimeve në terren.

3. PËRSHKRIMI I DËMEVE TË KONSTATUARA NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE DHE UJORE

3.1. Dëmtimet në infrastrukturën rrugore (Junik – Gjeravicë)


Në disa segmente rrugore është evidentuar:

- Rrëshqitje masive e dheut dhe gurëve nga shpatet anësore;
- Shembje e bankinave rrugore dhe humbje e stabilitetit të trupit të rrugës,
- Çarje dhe fundosje e asfaltit, duke rrezikuar seriozisht qarkullimin e automjeteve.

- Dalje e ujërave dhe baltës në trupin e rrugës, duke e bërë atë të pakalueshme ose me rrezik të lartë.

Këto dëmtime paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e qytetarëve dhe kërkojnë ndërhyrje emergjente.

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare dhe me fotografi dëmet e shkaktuara;



	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Çmimi totali(€)
1	Largimi i dheut nga trasea e rrugës.	m^3	20,000.00	5.00	100,000.00
2	Rregullimi i lëshesave	copë	3.00	40,000.00	120,000.00
3	Rregullimi i bazës dhe asfaltimi i pjesëve të dëmtuara	m^2	3,000.00	20.00	60,000.00
				Totali:	**280,000.00**

3.2. Dëmtimet në infrastrukturën rrugore (Junik – Rastavicë)

Nga reshjet intensive janë shkaktuar rrëshqitje të konsiderueshme të dheut në shpatet mbi dhe nën rrugë, duke rezultuar në:

- Dëmtim të bankinave dhe dalja e baltës në rrugë.
- Dëmtim i gypave përgjatë rrugës.

Këto dëmtime paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e qytetarëve dhe kërkojnë ndërhyrje emergjente.
Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare dhe me fotografi dëmet e shkaktuara:







	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Çmimi total(€)
1	Rregullimi i kanalit anësorë dhe bankinës	m	300.00	18.00	5,400.00
2	Rregullimi i gypave përgjatë rrugës	m	20.00	70.00	1,400.00
				Totali:	**6,800.00**

3.3. Dëmtimet në shtratin e lumit Erenik dhe infrastrukturën ujore

Gjatë inspektimit është konstatuar:

- Erozion i theksuar i shtratit të lumit,
- Zhvendosje e gurëve dhe materialit mbrojtës,
- Dëmtim dhe shembje e mureve mbrojtëse prej betoni,
- Ndryshim i rrjedhës natyrore të ujit, duke rritur rrezikun e përmbytjeve në zonat përreth,
- Dëmtimi i pendës për ujitje.

Në disa segmente, strukturat mbrojtëse kanë humbur funksionin e tyre, duke ekspozuar rrugët dhe zonat përreth ndaj rrezikut të dëmtimeve të mëtejshme.



	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Çmimi total(€)
1	Pastrimi i lumit nga mbetjet e ndryshme	m^3	5,000.00	5.00	25,000.00
2	Rregullimi i skarpatave dhe mureve nga betoni	m	1,000.00	50.00	50,000.00
3	Ndertimi i pendës per ujitje	Copë	1.00	120,000.00	120,000.00
				Totali:	**195,000.00**

3.4. Dëmtimet në infrastrukturën rrugore (rruga Nora e Kelmendit dhe Avdi Goqi)

Si pasojë e reshjeve të dendura të shiut, rrjedha e ujit që vjen nga rruga "Avdi Goqi", për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të shtratit ekzistues, ka dalë nga shtrati i saj natyror duke shkaktuar dëmtime në infrastrukturën rrugore në rrugën "Nora e Kelmendit". Dalja e ujit ka shkaktuar erozion, dëmtim të bankinave dhe dobësim të stabilitetit të rrugës.

Gjithashtu, rrjedha e ujit kalon nëpër oborret e disa shtëpive përreth ku me rritjen e ketyre reshjeve del nga shtrati i saj, duke shkaktuar dëme materiale në pronat e banorëve. Për këtë arsye, është e domosdoshme zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të rjedhës së ujit si dhe sanimi i infrastrukturës së dëmtuar, me qëllim parandalimin e dëmeve të mëtejshme.

Në këtë rrugë është evidentuar:

- Shembje e bankinave rrugore dhe humbje e stabilitetit të trupit të rrugës,
- Çarje dhe fundosje e asfaltit, duke rrezikuar seriozisht qarkullimin e automjeteve,
- Dalje e ujërave dhe baltës në trupin e rrugës, duke e bërë atë të pakalueshme ose me rrezik të lartë,
- Dëmtimin e pronës private.

Këto dëmtime paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e qytetarëve dhe kërkojnë ndërhyrje emergjente.
Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare dhe me fotografi dëmet e shkaktuara;






	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Çmimi totalit(€)
1	Rikonstruimi dhe rregullimi i kanalit egzistues	m	430.00	130.00	55,900.00
2	Asfaltimi i pjesës së dëmtuar të rrugës	m^2	1,500.00	20.00	30,000.00
				Totali:	**85,900.00**

3.5. Dëmtimet në shtratin e lumit Trava dhe infrastrukturën ujore

Gjatë inspektimit është konstatuar:

- Zhvendosje e gurëve dhe materialit mbrojtës,
- Ndryshim i rrjedhës natyrore të ujit, duke rritur rrezikun e përmbytjeve në zonat përreth,
- Dëmtimi i pendës për ujitje.

Në disa segmente te lumit ka mbetje te cilat duhet largur, po ashtu ka edhe devijim te rrjedhes duke e demtuar kanalin e pendës i cili shërben për ujitje. Vonesat në përmirësimin e gjendjes rrisin rrezikut e dëmtimeve të mëtejshme.



	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Çmimi total(€)
1	Largimi i materialit dhe formesimi i shtratit të lumit	m	300.00	25	7,500.00
2	Intervenimi ne pjesen e demtuar te kanali i pendes	copë	1.00	1,500.00	1,500.00
				Totali:	**10,000.00**

4. Përbledhja e dëmeve:

	Përshkrimi i pozicionit	Çmimi total(€)
1	Dëmtimet në infrastrukturën rrugore (Junik – Gjeravicë)	280,000.00
2	Dëmtimet në infrastrukturën rrugore (Junik – Rastavicë)	6,800.00
3	Dëmtimet në shtratin e lumit Erenik dhe infrastrukturën ujore	195,000.00
4	Dëmtimet në infrastrukturën rrugore (rruga Nora e Kelmendit dhe Avdi Goqi)	85,900.00
5	Dëmtimet në shtratin e lumit Trava dhe infrastrukturën ujore	10,000.00
	Totali:	**577,700.00**

5. DËMET NË EKONOMIT FAMILJARE DHE TOKAT BUJQËSORE

Si pasojë e reshjeve të mëdha dhe të vazhdueshme të shiut, janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomitë familjare dhe në tokat bujqësore. Sasia e madhe e ujit ka tejkaluar kapacitetin e kanaleve dhe shtratit natyror të rjedhës, duke shkaktuar përmbytje të oborreve dhe depërtim të ujit në shtëpi banimi, çka ka sjellë dëmtim të objekteve, pajisjeve shtëpiake dhe pronës me vlerë.
Po ashtu, tokat bujqësore janë përmbytur, duke shkaktuar humbje të kulturave bujqësore, dëmtim të mbjelljeve sezonale dhe ulje të rendimentit. Rrjedha e pakontrolluar e ujit ka shkaktuar edhe erozion të tokës, duke e bërë atë të papërshtatshme për punim në një periudhë të caktuar kohore.
Këto dëme kanë ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen ekonomike të familjeve të prekura, duke shkaktuar humbje financiare dhe vështirësi në sigurimin e të ardhurave bazë.

5.1. Objektet e dëmtuara (shtëpi banimi, prona, toka bujqësore, mure, depo, paisje dhe automjete)

Tabela 1. Ekonomitw familjare tw dëmtuara nga vershimet:

Nr.	Pronari	Nr. personal	Objektet/dëmtimet	Vlera e dëmit në €
1.	Tahir Qestaj	1009819080	Gerryerje e themelit te murit te oborrit.	600.00€
2.	Aziz Miroci	1500930574	Dëmtim i tokës bujqësore.	850.00€
3.	Flurim Shehu	1003444640	Demtim i mjeteve dhe paisjeve elektrike dhe vetures.	1,130.00€
4.	Sylë Qestaj	1003444950	Dëmtim i paisjeve shtepiake dhe mobiljeve.	1,100.00€
5.	Zog Goçi	1009370052	Dëmtim i murve (suvatimit).	650.00€
6.	Gjon Llolluni	1009814996	Dëmtim i murve (suvatimit).	950.00€
				8,750.00€

Tabela 2. Biznesët e dëmtuara nga vershimet:

Nr.	Pronari	Nr. personal	Objektet/dëmtimet	Vlera e dëmit në €
1.	Isuf Hebibi	1003448505	Demtim i paisjeve elektrike, invertarit , dyshemese dhe mureve.	12,000.00€
2.	Valbona Gaxherri Gacaferi	1234418253	Demtim i matriallit ndertimor.	2,471.00€
				14,471.00€

Tabela 3. Tokat bujqesore tw dëmtuara nga vershimet:


Nr.	Pronari	Nr. personal	Objektet/dëmtimet	Vlera e dëmit në €
1	Qamil Iasiqi	1009373396	Rreshqitje e dheut (dëmtim i pronës).	900.00€
2.	Ali Shala	2009370857	Dëmtim i tokës bujqësore.	750.00€
3.	Xhavit Shala	1009374961	Dëmtim i tokës bujqësore.	1,500.00€

4.	Faton Gaxherri	1009817413	Dëmtim i tokës bujqësore.	1,200.00€
5.	Aziz Miroci	1500910574	Dëmtim i tokës bujqësore.	850.00€
				5,200.00€


Tabela 3. Veturat e dyemtuara:

Nr.	Pronari	Nr. personal	Objektet/dëmtimet	Vlera e dëmit në €
3.	Flurim Shehu	1003444640	Demtim i veturws e tipit Mercedes.	3,470.00€
				3,470.00€

Foto:







6. VLERËSIMI I GJENDJES

Bazuar në gjendjen e konstatuar në terren, Komisioni vlerëson se:

- Dëmet janë të konsiderueshme dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente,
- Mosndërhyrja në kohë mund të çojë në përkeqësim të situatës dhe rrezikim të sigurisë publike,
- Infrastrukturës i është cenuar funksionaliteti dhe stabiliteti në disa zona kyçe.
- Demtimet ne prona private dhe toka bujqësore.

7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Komisioni rekomandon:

- Ndërhyrje emergjente për stabilizimin e rrëshqitjeve të dheut,
- Sanimin e trupit të rrugëve të dëmtuara dhe rikthimin e qarkullimit të sigurt,
- Riparimin dhe rindërtimin e mureve mbrojtëse dhe rregullimin e shtratit të lumit Erenik,
- Marrjen e masave parandaluese për shmangien e dëmeve të ngjashme në të ardhmen.

8. PËRFUNDIM

Ky raport paraqet gjendjen reale të dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Komunën e Junikut dhe shërben si bazë për planifikimin e ndërhyrjeve emergjente dhe sigurimin e fondeve për sanimin e infrastrukturës së dëmtuar.

Komisioni:

1. Shkelzen Shehu – kryesues
2. Idriz Gacaferi – anëtarë
3. Arian Xhuli – anëtarë
4. Iliriana Isufaj – anëtare
5. Sundim Krasniqi – anëtarë